



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Alqi Paguni**, më datë **14.06.2024** Nr. Regj.Them. 371, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me objekt: Shuarjen e veprës penale ose dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit në bazë të nenit 68 të Kodit Penal, vendimit unifikues të Gjykatës Lartë, nr.7, datë 11.10.2002.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, mbështetur në nenet 75/a, 83, 89, 90 e vijues, 470 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 371, datë 02.07.2024, vendosi:

1. Ngritjen përpara Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, të mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore, për shqyrtimin e çështjes penale me nr.371, datë 14.06.2024, që i përket kërkuesit: **Alqi Paguni**, me objekt: Kërkohet të vërtetohet shuarja e veprës penale ose dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit në bazë të nenit 68 të Kodit Penal, vendimit unifikues të Gjykatës Lartë, nr.7, datë 11.10.2002, dhe nenit 480 të K.Pr.Penale, ndërmjet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
2. Kopje të akteve të kësaj çështjeje ti dërgohen Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.
3. Ky vendim t’iu njoftohet nga sekretaria e kësaj gjykate, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Tiranë më datë 02.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar